



Office of the Commissioner General for Refugees and Stateless Persons

UDHËZUES PËR TË MITURIN E PASHOQËRUAR I CILI KËRKON AZIL NË BELGJIKË



Kjo broshurë dhe të gjitha botimet gjuhësore janë në dispozicion në faqen e internetit të CGRS:

This brochure and all language editions are available on the website of the CGRS:

www.cgrs.be/en/publications

Publisher:

Office of the Commissioner General for Refugees and Stateless Persons (CGRS)
Rue Ernest Blerot 39
1070 BRUSSELS

Edition:

August 2025



**Co-funded by the
European Union**

PËRMBAJTJA

MIRDITA	4
PROCEDURA E AZILIT	6

1	ÇFARË MBROJTJE MUND TË MARRËSH NË BELGJIKË?	8
	DY LLOJET E AZILIT	9
	ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT?	10
	ÇFARË ËSHTË MBROJTJA PLOTËSUESE?	11

2	JE IDENTIFIKUAR DHE REGJISTRUAR SI I MITUR I HUAJ I PASHOQËRUAR	12
	TI JE NJË I MITUR I HUAJ I PASHOQËRUAR	13
	MOSHA JOTE DUHET TË PËRCAKTOHET	14
	KUJDESTARI YT	15
	VENDSTREHIMI YT	16
	DEKLARATA JOTE DHE PYETËSORI NË ZYRËN E TË HUAJVE	17

3	PROCEDURA JOTE E AZILIT NË KOMISARIATIN E PËRCJITHSHËM PËR REFUGJATË DHE APATRIDË	18
	NJË SPECIALIST SHQYRTON KËRKESËN TËNDE PËR AZIL	19
	ZYRTARI MBROJTËS TË INTERVISTON NË MËNYRË TË DETAJUAR	20
	ÇFARË MUND TË PRESËSH GJATË INTERVISTËS TËNDE NË CGRA?	22
	ÇFARË PRET ZYRTARI MBROJTËS PREJ TEJE GJATË INTERVISTËS TËNDE NË CGRA?	23
	SHQYRTIMI I KËRKESËS TËNDE PËR AZIL	24
	VENDIMI	25
	NEGATIV: KËRKESA JOTE PËR AZIL ËSHTË REFUZUAR. ÇFARË DUHET TË BËSH TANI?	26
	ANKESA KUNDËR VENDIMIT NEGATIV	26
	POZITIV : JE I NJOHUR SI REFUGJAT	27
	ÇFARË NDRYSHON STATUSI I REFUGJATIT PËR TY?	27
	POZITIV: KE MARRË STATUSIN E MBROJTJES PLOTËSUESE	28
	ÇKA NDRYSHON PËR TY STATUSI I MBROJTJES PLOTËSUESE?	28

KONTAKTET	30
-----------	----

MIRDITA

Çdo fëmijë është i ndjeshëm. Aq më shumë një i mitur i huaj i pashoqëruar. Pas një udhëtimi shpesh traumatizues, këta të mitur janë të vetmuar për të kërkuar azil në një vend me një kulturë tjetër. Fëmijët dhe të miturit që kërkojnë azil e kanë shpesh të vështirë për të treguar se çfarë ju ka ndodhur në vendin e tyre.

Kjo është arsyeja pse CGRA parashikon një procedurë të veçantë për trajtimin e kërkesave të azil të të miturve të huaj të pashoqëruar.

Ky udhëzues të shpjegon rrugën që ti duhet të ndjekësh si i mitur i huaj i pashoqëruar i cili kërkon azil në Belgjikë. Çdo i mitur i pashoqëruar pajiset me këtë udhëzues ditën që parashtron kërkesën e tij për azil në Zyrën e të huajve.

Më shumë informata?

Ti mund të gesh një përmbledhje të kësaj broshure në:


www.cgra.be/en/asylum/children-asylum-procedure

Gjithashtu, në faqen e internetit të CGRA, do të gesh shumë informacione tjera mbi procedurat e azilit në Belgjikë.





Ajo që ti duhet
gjithsesi të mbash
në mend është
shënuar me top
të gjelbërt.

Faqet interesante të
internetit janë të shënuara
me top të kaltërt.



PROCEDURA E AZILIT





1

ÇFARË MBROJTJE MUND TË MARRËSH NË BELGJIKË?



UDHËZUES PËR TË MITURIN E PASHOQËRUAR



DY LLOJET E AZILIT



Ti kërkon azil në Belgjikë. Kjo do të thotë që ti kërkon nga Belgjika për të të mbrojtur, sepse ke pasur probleme në vendin tënd, ose ngaqë je frikësuar se do të keshë probleme në vendin tënd. Ti mendon se nuk mund të kthehesh në vendin tënd për shkak të këtyre problemeve. Belgjika ofron dy lloje të azilit: statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese.




ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT?

Belgjika ka nënshkruar Konventën e Gjenevës për statusin e refugjatëve. Kjo marrëveshje ndërkombëtare detyron Belgjikën për t'iu dhënë mbrojtje personave që janë të persekutuar, ose që kanë frikë nga persekutimi në vendin e tyre të origjinës apo vendin ku ata jetojnë zakonisht. Persekutimet mund të kenë shumë arsye të ndryshme:

- i detë e tua politike ose ato të familjes tënde
- f eja jote
- raca jote
- kombësia jote
- Ky është një grup njerëzish që kanë te përbashkët një karakteristikë e cila i bën ata të ndryshëm nga pjesa tjetër e popullsisë së vendit të tyre. Për shkak të kësaj karakteristike, të cilën ata nuk mund ta ndryshojnë, ata trajtohen në mënyrë armiqësore nga autoritetet ose nga pjesa tjetër e popullsisë. Për shembull, persekutimi për shkak të të qenurit homoseksual.

Nëse e ke lënë vendin tënd për një ose më shumë nga këto arsye, ose në qoftë se një nga këto arsye të ndalon te kthehesh në vendin tënd, atëherë ti mund të marrësh statusin e refugjatit në Belgjikë.



ÇFARË ËSHTË MBROJTJA PLOTËSUESE?



Nëse situata jote nuk të lejon të marrësh statusin e refugjatit, CGRA do të shqyrtojë nëse ti mund të marrësh statusin e mbrojtjes plotësuese.

CGRA do të ta japë këtë status në qoftë se ndodhesh në një rrezik real ku mund të përjetosh një shkelje të rëndë nëse kthehesh në vendin tënd, për shembull:

- dënim me vdekje apo ekzekutim
- tortura apo trajtime të tjera çnjerëzore ose poshtëruese
- kërcënime serioze për jetën tënde për shkak të një konflikti të armatosur apo të një lufte civile.

2

JE IDENTIFIKUAR DHE REGJISTRUAR SI I MITUR I HUAJ I PASHOQËRUAR



UDHËZUES PËR TË MITURIN E PASHOQËRUAR

TI JE NJË I MITUR I HUAJ I PASHOQËRUAR

- nëse nuk i ke mbushur ende 18 vjet
- nëse ndodhesh në Belgjikë pa prindërit e tu ose kujdestarin (ligjor)
- nëse vjen nga një vend jashtë Bashkimit Evropian
- dhe nëse ti ke kërkuar azil në Belgjikë ose nëse ndodhesh në Belgjikë pa dokumentat e nevojshme.

Ti mundesh, vetëm ose me kujdestarin tënd, të kërkohesh azil në Zyrën e të huajve (OE), ose në kufi. Nëse je vetëm, OE sinjalizon praninë tënde te Shërbimi i Kujdestarisë.

OE e plotëson, me ndihmën tënde, një formular sinjalizimi për të informuar Shërbimin e Kujdestarisë se që ardhur vetëm në Belgjikë. Shërbimi i Kujdestarisë kujdeset që të drejtat tua të respektohen ashtu siç duhet. Në fakt, si një fëmijë apo i mitur, ti ke nevojë për mbrojtje të veçantë.



Më shumë informata?


KTHIMI NË VENDIN TËND

Nëse dëshiron, ti mund të vendosësh për t'u kthyer përfundimisht në vendin tënd, edhe në qoftë se ke kërkuar azil. Ti mund të kërkohesh ndihmë për përgatitjen e udhëtimit dhe shoqërim gjatë udhëtimit tënd. Nëse planifikon kthimin në vendin tënd, ti mund të flasësh me kujdestarin ose asistentin tënd social. Ti do të gjesh më shumë informacione në faqen e mëposhtme:

www.voluntaryreturn.be



MOSHA JOTE DUHET TË PËRCAKTOHET



Nëse ka një dyshim në lidhje me moshën tënde, do t'i nënshtrohesh një ekzaminimi për të **përcaktuar moshën**. Bëhet fjalë për një ekzaminim mjekësor për të mësuar moshën tënde të vërtetë. Do të bëhen fotografitë me rreze X të dhëmbëve tu dhe të kockave tua të dorës dhe të shpatullës. Këto fotografi mundësojnë përcaktimin e përafërt të moshës tënde. Nëse nuk pajtohesh me rezultatet e ekzaminimit mjekësor, mund të **parashtrosh ankesë** brenda 60 ditëve para Këshillit të Shtetit. Avokati yt do të të ndihmojë për këtë. Nëse ky ekzaminim tregon se je 18 vjeç ose më shumë, Shërbimi i Kujdestarisë nuk do të caktojë një kujdestar për të të ndihmuar. Do të trajtohesh si një i rritur.



KUJDESTARI YT



Nëse nuk ka asnjë dyshim në lidhje me moshën tënde, ose nëse ekzaminimi mjekësor tregon se je i mitur, Shërbimi i Kujdestarisë do të caktojë menjëherë një **kujdestar** për ty.

Kujdestari yt është përfaqësuesi yt ligjor për kohën që ti do të qëndrosh në Belgjikë dhe deri sa të mbushësh 18 vjet. Roli i tij përfundon në ditën e ditëlindjes tënde të 18 vjetorit, përveç në qoftë se prindërit e tu, ose personi i cili ishte përgjegjës për ty në vendin tënd, mbërrijnë në Belgjikë. Kujdestari yt do të të gjejë një avokat për të të ndihmuar gjatë procedurës së azilit. Ai gjithashtu kujdeset që të respektohen si duhet të drejtat tua, nëse ti shkon në shkollë, nëse janë në rregull dokumentat tua administrative etj... Ai të ndihmon për kërkesën tënde të azilit dhe të shpjegon se çfarë mund të presësh nga procedura. Kujdestari yt do të jetë i pranishëm me ty gjatë intervistave në Zyrën e të Huajve dhe në Komisarjatin e Përgjithshëm, për të siguruar që intervistuesi do të respektojë të drejtat tua. Gjatë intervistave, kujdestari yt mund të bëjë vërejtje në lidhje me situatën tënde.

VENDSTREHIMI YT



Si i mitur i huaj i pashoqëruar, do të të japin një vendstrehim. Ky strehim organizohet nga Fedasil, i cili është përgjegjës për strehimin e azilkërkuesve në Belgjikë. Nëse anëtarët e familjes tënde jetojnë në Belgjikë, ti gjithashtu mund të zgjedhësh që të jetosh tek ata.

Vendstrehimi yt do të përshtatet nevojave të tua dhe do të jetë i ndarë nga të rriturit. Të gjitha qendrat e banimit të Fedasil dhe të organizatave që punojnë me Fedasil (si Kryqi i Kuq) janë “qendra të hapura”: ti mund të hysh e të dalësh lirshëm për aq kohë sa të respektosh rregulloren e qendrës.

Do të japin një vendstrehim për kohëzgjatjen e procedurës së azilit. Nëse ende nuk ke marrë një vendim, kur t’i mbushësh 18 vjet, do të transferohesh në një qendër strehimi për të rritur.

Si i mitur do të regjistrohesh në një shkollë, sepse shkolla është e detyrueshme deri në moshën 18 vjeçare në Belgjikë. Nëse jeton në familje, ti duhet gjithashtu të shkosh në shkollë.

DEKLARATA JOTE DHE PYETËSORI NË ZYRËN E TË HUAJVE

OE do të të ftojë me kujdestarin tënd.

Një zyrtar i OE në fillim e plotëson me ty një **deklaratë me të dhënat e tua të identitetit**.

Pastaj, ti mund të shpjegosh në **një intervistë të shkurtër përse je larguar nga vendi yt** dhe përse nuk don ose nuk mund të kthehesh. Kjo intervistë bazohet në një pyetësor. Është shumë e rëndësishme që të japësh një ide të qartë të **situatës tënde dhe të origjinës tënde**.

Ti duhet pra të japësh informacione të sakta dhe të plota mbi pikat e mëposhtme:

- i identitetin tënd dhe kombësinë tënde
- vendet ku ke jetuar para se të vish në Belgjikë
- emrat e prindërve të tu dhe të vëllezërve e
- motrave të tua si dhe vendin ku ata jetojnë
- udhëtimin tënd
- të gjitha arsyet për të cilat e ke lënë vendin tënd.

Nëse nuk flet mirë frëngjisht apo holandisht, do të ketë një përkthyes për të përkthyer pyetjet e personit që te merr ne pyetje dhe përgjigjet tua. Përkthyesi dhe intervistuesi duhet të respektojë sekretin profesional.

Ata nuk mund të japin informacione lidhur me kërkesën tënde për azil personave të jashtëm apo autoriteteve të vendit tënd.

Pas kësaj interviste, OE e dërgon kërkesën tënde për azil në CGRA.

3

PROCEDURA JOTE E AZILIT NË KOMISARIATIN E PËRGJITHSHËM PËR REFUGJATË DHE APATRIDË



UDHËZUES PËR TË MITURIN E PASHOQËRUAR

NJË SPECIALIST SHQYRTON KËRKESËN TËNDE PËR AZIL



CGRA ka një ekip të zyrtarëve mbrojtës të specializuar në trajtimin e kërkesave për azil të të miturëve të pashoqëruar. Zyrtari mbrojtës është personi i cili shqyrton kërkesën tënde për azil në CGRA. Ai është i formuar posaçërisht për këtë. Ndër të tjera, ai ka ndjekur një përgatitje të veçantë për të intervistuar të miturit. Ai e përshtatë intervistën në bazë të moshës tënde, nivelin tënd shkollor dhe nevojat e tua të veçanta. Nëse është e nevojshme, ai do të të kërkojë të vizatosh ose të përdorësh imazhe gjatë intervistës për të të ndihmuar të tregosh historinë tënde në mënyrën më të qartë sa me të plotë.

Vendimi përfundimtar për kërkesën tënde për azil do të mirret nga komisar i përgjithshëm për refugjatë dhe apatridë ose nga njëri prej zëvendësve të tij.



ZYRTARI MBROJTËS TË INTERVISTON NË MËNYRË TË DETAJUAR

Kur CGRA e merr dosjen tënde nga OE, ai do të të ftojë bashkë me kujdestarin dhe avokatin tënd për një intervistë.

Intervista në CGRA është **pjesa më e rëndësishme e procedurës së azilit**. Në të vërtetë, kjo intervistë të mundëson për të shpjeguar në detaje pse ke kërkuar azil në Belgjikë.

Ti do të marrësh një letër me datën dhe kohën e intervistës tënde. Prania jote dhe prania e kujdestarit tënd janë **të detyrueshme**. Nëse nuk mund të vish në intervistën tënde, për shembull, ngaqë je i sëmurë, kujdestari yt duhet, brenda 8 ditëve, të informojnë CGRA për arsyen e mungesës tënde. Ai gjithashtu do të dërgojë një çertifikatë për të justifikuar mungesën tënde. Pastaj do të marrësh një ftesë të re për intervistën tënde.

Kujdestari dhe avokati yt do të përgadisin intervistën me ty. Para intervistës, **është shumë e rëndësishme që të mbledhësh sa më shumë informacione të mundshme dhe dokumenta për identitetin tënd, moshën tënde, udhëtimin tënd, arsyet e kërkesës tënde për azil dhe vendin ku jeton familja jote**. Kjo është e nevojshme në mënyrë që CGRA të mund të shqyrtojë në mënyrë korrekte kërkesën tënde dhe të marrë një vendim të shpejtë. Kujdestari dhe avokati yt mund të të ndihmojnë në mbledhjen e këtyre informacioneve.



Intervista zhvillohet në CGRA, në një zyre të përshtatshëm.



Nëse nuk flet mirë frëngjisht ose holandisht, një **përkthyes** do të përkthejë gjatë intervistës. Përkthyesi është aty vetëm për të përkthyer atë që thua ti dhe atë që thotë oficeri mbrojtës. Ai nuk merr pjesë në shqyrtimin e kërkesës tënde për azil. Si në OE, zyrtari mbrojtës i CGRA dhe përkthyesi duhet të respektojnë **sekretin profesional**.

Ti mund të kërkohësh gjithashtu nga një **person i besueshëm** të të shoqërojë gjatë intervistës tënde. Bëhet fjalë për një person të cilit i beson dhe që punon me ty në kuadrin e profesionit të tij (një psikolog, një mësues, një punonjës social, ...).



ÇFARË MUND TË PRESËSH GJATË INTERVISTËS TËNDE NË CGRA?

Zyrtari mbrojtës udhëheq intervistën. Roli i tij para të gjithash është të të dëgjoj.

Zyrtari mbrojtës do të të parashtrojë pyetje. Tregoj atij çdo gjë që ti din në lidhje me veten tënde, në lidhje me problemet e tua apo problemet e të afërmëve të tu. Ai gjithashtu do të të bëjë pyetje për udhëtimin tënd dhe dokumentet tua.

Nëse nuk e kupton një pyetje ose nëse ka ndonjë problem gjatë intervistës, duhet t'a thuash menjëherë për të shmangur keqkuptimet. Zyrtari mbrojtës do të të bëjë të njëjtën pyetje por me fjalë tjera.

Nëse **nuk e din përgjigjen** në një pyetje, vetëm përgjigju që nuk e din.

Mos e shpik pra përgjigjen. Merr kohë për të menduar për atë që do të tregosh.

Jep përgjigje të sinqerta dhe të plota.

Intervista mund të zgjasë disa orë, por janë parashikuar pushime të shkurta.

Ti mund të kërkosh vetë për të bërë një pushim.

Kujdestari yt mund të bëjë vërejtje gjatë intervistës tënde.

Pas intervistës, ti mund të **japësh informacione shtesë ose dokumenta** në dosjen tënde.

Kujdestari dhe avokati yt mund të të ndihmojnë lidhur me këtë.





ÇFARË PRET ZYRTARI MBROJTËS PREJ TEJE GJATË INTERVISTËS TËNDE NË CGRA?

Për të shqyrtuar kërkesën tënde, CGRA duhet të ketë të gjitha informacionet e nevojshme. Ligji të detyron që të bashkëpunosh në mënyrë aktive me CGRA.

Ja se çfarë pret oficeri mbrojtës prej teje :

- Tregoj atij të vërtetën. Jepi përgjigje të sinqerta dhe sa më të plota të jetë e mundur.
- Tregoj atij, nëse është e mundur, dokumentat që mund të vertetojnë:
 - moshën tënde
 - identitetin tën
 - kombësinë tënde
 - origjinën tënd
 - vendet ku ke jetuar dhe vendet ku kanë jetuar prindërit e tu, vëllezërit e tu dhe motrat e tu
 - udhëtimin tënd
 - problemet që ke pasur në vendin tënd

Nëse CGRA konstaton se ke bërë deklaratata të pasakta ose të rreme, ose që ke treguar dokumenta të falsifikuara, kërkesa jote për azil mund të refuzohet. Nëse CGRA zbulon mashtrimin pasi të kesh marrë një status të mbrojtjes, ai mund të tërheqë statusin tënd.

Kjo gjithashtu mund të ketë pasoja negative për pjesëtarët e familjes tënde që janë bashkuar me ty në Belgjikë përmes bashkimit familjar.

Nëse nuk jep asnjë informacion që mundëson për të pasur një ide të situatës tënde reale, ose në qoftë se ti nuk e shpjegon pse nuk mund të japësh këto informacione, CGRA nuk do të mund të dijë nëse frika jote e persekutimit është e justifikuar apo jo. Edhe në këtë rast, kërkesa jote për azil mund të refuzohet.





SHQYRTIMI I KËRKESËS TËNDE PËR AZIL

Pas intervistës tënde në CGRA, zyrtari mbrojtës do të shqyrtojë në detaje kërkesën tënde për azil. Ai mbi të gjitha do të verifikojë:

- nëse ti ke dhënë përgjigje të besueshme
- dokumentet që ke sjellur për të justifikuar kërkesën tënde për azil
- karakterin personal të kërkesës tënde për azil: çdo kërkesë e azilit shqyrtohet individualisht; zyrtari mbrojtës do të verifikojë frikën tënde personale në rast kthimi dhe nëse kjo frikë është e justifikuar.
- gjendjen e përgjithshme në vendin tënd të origjinës ose në vendin ku ke jetuar zakonisht.

Për të marrë një vendim për kërkesën tënde për azil, CGRA merr parasysh moshën tënde, pjekurinë tënde, nivelin tënd të shkollimit dhe nevojat tua të veçanta.

Interesi superior i fëmijës dhe cënueshmëria e fëmijës luajnë një rol vendimtar në shqyrtim. Fëmijët shohin botën rreth tyre në një mënyrë të ndryshme nga të rriturit dhe nuk kuptojnë të gjitha ngjarjet rreth tyre. CGRA pra nuk pret nga ti një përgjigje të qartë për të gjitha pyetjet që të parashtrohen.

Në qoftë se është e nevojshme dhe është e mundur, CGRA mund të thërrasë gjithashtu dëshmitarë gjatë intervistës, për shembull një xhaxha apo një hallë, që ndodhet gjithashtu në Belgjikë dhe mund të sqarojë situatën tënde.

Për të shqyrtuar në mënyrë korrekte kërkesën tënde të azilit, CGRA përdor gjithashtu informacione mbi situatën specifike të fëmijëve dhe të miturve në vendin tënd.



VENDIMI



Pak kohë pas intervistës tënde, do të marrësh një vendim nga CGRA.

Originali i këtij vendimi i dërgohet kujdestarit tënd. Avokati yt merr një kopje. Ti do të marrësh personalisht një kopje me postë ose me faks në qendrën tënde të strehimit. Në vendimin e tij, Komisar i përgjithshëm përdor gjuhën e përshtatshme për moshën tënde dhe profilin tënd.

Nëse merr një vendim negativ, kujdestari yt, avokati ose asistenti yt social mund të të shpjegojnë arsyet e këtij vendimi.



Më shumë informata?

Bazuar në të gjitha elementet e dosjes tënde, Komisar i përgjithshëm merr një vendim pozitiv (statusi i refugjatit ose statusi i mbrojtjes plotësuese) ose një vendim negativ (refuzimin e statusit). Ka disa lloje të vendimeve. Lexoni më shumë në

www.cgrs.be/en/asylum/types-decisions



NEGATIV: KËRKESA JOTE PËR AZIL ËSHTË REFUZUAR. ÇFARË DUHET TË BËSH TANI?

CGRA ka marrë vendim për refuzimin e statusit të refugjatit dhe refuzimin e statusit të mbrojtjes plotësuese. Kjo do të thotë se nuk ka elemente të mjaftueshme në dosjen tënde për të vertetuar se frika jote e persekutimit është e justifikuar apo se ndodhesh në një rrezik real të shkeljeve të rënda nëse kthehesh në vendin tënd. Në vendim, CGRA të shpjegon arsyet e refuzimit

ANKESA KUNDËR VENDIMIT NEGATIV

CGRA ka marrë vendim që të të refuzoj statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese? Ose ti ke marrë statusin e mbrojtjes plotësuese dhe dëshiron të marrësh statusin e refugjatit? Në këtë rast, ti mund të **ankohesh** kundër vendimit të CGRA në Këshillin kontestues për të huajt. Kujdestari dhe avokati yt do të të ndihmojnë për këtë. Ti ke të drejtë të qëndrosh në Belgjikë gjatë procedurës të ankesës, ose deri në moshën 18 vjeçare. Nëse ankesa jote është refuzuar, ti duhet të kthehesh në vendin tënd kur t'i mbushësh 18 vjeç.



Më shumë informata?

Këshilli kontestues për të huajt (CCE) shqyrton ankesat kundër vendimeve refuzuese të CGRA. Ka disa procedura të ankesës, në varësi të llojit të vendimit. Vendimi i CCE-së merr formën e një vendimi të arsyetuar. Lexo më shumë në:

www.cgrs.be/en/international-protection/appeals-procedures

POZITIV : JE I NJOHUR SI REFUGJAT

Decision to recognise refugee status: you have been recognised as a refugee by the CGRS.

ÇFARË NDRYSHON STATUSI I REFUGJATIT PËR TY?

Fillimisht do të marrësh një leje qëndrimi në Belgjikë për një periudhë të kufizuar (5 vjet). Kjo gjithashtu do të thotë, ndër të tjera, se prindërit tu, vëllezërit e tu dhe motrat e tua mund të paraqesin një kërkesë për bashkim familjar në Belgjikë.

Rreth 30 ditë pas marrjes së vendimit, do të marrësh **vërtetimin e refugjatit**. CGRA do të t'a dërgoj automatikisht këtë dokument.

Nëse ke nevojë për dokumente të gjendjes civile (p.sh. një çertifikatë të lindjes), ti duhet të bësh një kërkesë me shkrim në “Helpdesk refugjatët e njohur dhe personat pa shtetësi” të CGRA. Nëse doni të merrni një pasaportë për të udhëtuar jashtë shtetit, duhet të parashtrosh një kërkesë në administratën provinciale të komunës ku banon. Si refugjati njohur, nuk ke të drejtë të kthehesh në vendin tënd.



Më shumë informata?

Si refugjat i njohur në Belgjikë, ti duhet të respektosh ligjet e Belgjikës. Mund të gjesh më shumë informacione në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tua si refugjat dhe dokumentat që CGRA mund të lëshojë për refugjatët e njohur në:

www.cgrs.be/en/international-protection/refugee-status

www.cgrs.be/en/documents

POZITIV: KE MARRË STATUSIN E MBROJTJES PLOTËSUESE

Vendimi për refuzimin e statusit të refugjatit dhe të dhënies së statusit të mbrojtjes plotësuese: nuk ka arsye të mjaftueshme për të të njohur si refugjat, por nuk mund të kthehesh në vendin tënd për momentin, sepse je në një rrezik real të pësosh shkelje të rënda.

ÇKA NDRYSHON PËR TY STATUSI I MBROJTJES PLOTËSUESE?

Fillimisht do të marrësh një leje qëndrimi 1 vjeçare. Kjo leje pastaj mund të zgjatet. Prindërit e tu, vëllezërit e tu dhe motrat e tua mund të paraqesin një kërkesë për bashkim familjar në Belgjikë.

CGRA nuk i lëshon dokumenta personave të cilët kanë marrë statusin e mbrojtjes plotësuese. Nëse don të udhëtosh jashtë shtetit, ti duhet në parim të përdorësh një pasaportë të vendit tënd.



Më shumë informata?

Nëse e ke marrë statusin e mbrojtjes plotësuese, disa ligje të vendit tënd të origjinës mbesin të vlefshëm në Belgjikë, siç janë për shembull ligjet mbi moshën madhore ligjore dhe vlefshmërinë e martesës.

Më shumë informacione në:

www.cgrs.be/en/international-protection/subsidiary-protection-status

I remember
this!

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



UDHËZUES PËR TË MITURIN E PASHOQËRUAR

Kontaktet

COMMISSIONER GENERAL FOR REFUGEES AND STATELESS PERSONS

Rue Ernest Blerot 39

1070 BRUSSELS

Telefon : 02 205 51 11

Nga jashtë ju lutem telefononi : +32 2 205 51 11

Faks : 02 205 50 01

Email : cgvs.info@ibz.fgov.be

Faqja e internetit : www.cgrs.be

CELULA PËR TË MITURIT

CGRA ka një kordinatore për azilkërkuesit e mitur. Ajo është e informuar për çdo gjë në lidhje me trajtimin e kërkesave për azil të të miturve të pashoqëruar. Ajo ndjek nga afër dosjet e tyre. Për çdo pyetje ose vërejtje, kujdestarët mund t'i drejtohen kordinatores për të miturit.

Email : CGRA-CGVS.Mineurs@ibz.fgov.be

Telefon : 02 205 53 06

Nga jashtë ju lutem telefononi : +32 2 205 53 06

Faks : 02 205 50 05

Si instancë qendrore dhe e pavarur për azil, CGRA është në kontakt me shumë partnerë belg, evropianë dhe ndërkombëtarë.

Lexo më shumë në : www.cgrs.be/en/partners



Dëshiron të
dish më shumë
rreth **CGRA?**

Më shumë
informacione
mund të gjesh në :
www.cgrs.be





Office of the Commissioner General for
Refugees and Stateless Persons (CGRS)

www.cgvs.be



www.asyluminbelgium.be



Rue Ernest Blerot, 39
1070 BRUSSELS
Belgium